



Komunikatë

8.01.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën është shqyrtuar agjenda e punëve dhe detyrave që lidhen me procesin zgjedhor. Pas miratimit të rendit të ditës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dëgjuar informacionin e Zyres për Regjistrimin e Partive Politike (ZRPP), lidhur me Deklarimin Financiar të Subjekteve Politike gjatë fushatës zgjedhore. Fehmi Pireva, zyrtar ligjor në ZRPP, ka thënë se në bazë të nenit 40.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 2.1, 3.1 të Rregulles Zgjedhore nr. 12/2009, Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar, të gjitha Subjektet Politike të certifikuara që marrin pjesë në zgjedhje, janë të obliguara t'i sjellin Raportet e Deklarimit Financiar të Subjektit për periudhën nëntëdhjetë ditë (90) para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve, deri më 31 dhjetor 2009.

Në ZRPP, nga gjithsej shtatëdhjetë e katër (74) subjekte politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale, Formularët e Publikimit Financiar të Fushatës së Subjektit ia kanë dorëzuar tridhjetë e nëntë (39) Subjekte Politike. Raportet e Deklarimit Financiar për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave i kanë dorëzuar dy subjekte politike.

Burim Ahmetaj, kordinator i Qendres së Numrimit të Rezultateve (QNR), e ka informuar KQZ-në lidhur me procesin e hetimit dhe të rinumrimit të votave të komunës së Gjilanit. Procesi i hetimit dhe rinumrimit të votave ka përfunduar. Gjatë hetimit dhe rinumrimit nuk janë gjetur parregullsi të cilat do të mund ta dëmtojnë procesin. Janë hetuar dhe rinumruar votat në 127 vendvotime, kurse vetëm dy kuti nuk janë rinumruar, pasi që më herët ishin përjashtuar nga ky proces. Të shtunën do të sjellim një raport detal nga formularët origjinalë, të cilët janë sjellë nga vendvotimet që kanë dalë si rezultat i rinumrimit të votave. Po ashtu do të sjellim edhe raporin detal lidhur me hetimin që është bërë në Listën përfundimtare të votuesëve, në Librin e votimit dhe në të gjitha materialet që kanë qenë brenda kutisë së votimit. Procesi i rinumrimit ka qenë transparent dhe i hapur ku kanë qenë të pranishëm edhe vëzhguesit dhe palët e interesuara.

Gjatë shqyrtimit të procesit të Gjilanit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi që të shtunen (në mbledhjen e radhës), të merret një vendim nëse do

të numërohen të gjitha votat me kusht apo, vetëm ato që janë objekt ankese të KAZAP-it.

Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, tha se është një propozim që të shtunën (9 dhjetor), pasi QNR të sjellë raportin e detajizuar lidhur me hetimin dhe rinumrimin e votave të rregullta, të vendoset për votat me kusht. Besojmë që raporti i QNR-së do të jetë shumë konkret me të gjeturat gjatë rinumrimit dhe hetimit.

Në vazhdim të mbledhjes, u diskutua edhe për fushatën që duhet të bëhet për komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit. KQZ miratoi vendimin me shumicë votash që fushata për procesin e rivotimit në këto dy komuna, të bëhet prej datës 25janar (ora: 24.00), deri më datën 29janar (ora: 24.00).